



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____/2022

Datë: 07.03.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 18 pika C të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.011-10 i miratuar 16.12.2008, dhe në nenin 15 të Rregullores 01nr110/01-3650 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës e miratuar me dt. 30.01.2020, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.03.2022 pas diskutimit lidhur me pikën 3 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për mbështetje financiare të Shoqatës “Handikos Gjakovë” e miratoi këtë:

V E N D I M

Për

mbështetje financiare të shoqatës “Handikos Gjakovë”

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës “Handikos Gjakovë” për mbështetje financiare në vlerë prej 20.000€ me qëllim të përkrahjes për realizimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara që ofrohen nga “Handikos Gjakovë” .
2. Mjetet financiare në vlerë prej 20.000€ për Shoqatën “Handikos Gjakovë” ndahen nga Kategoria e Subvencioneve Komunale të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenieje Sociale .
3. Obligohen organet e Administratës Komunale për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore në fuqi, për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal .
 - Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenieje Sociale
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit .



Znj. Arbëneshja Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës